



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**Agjencia e Prokurimit Publik**

---

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Keshilli i Ministrave, Tel & Fax: 042277510*

**U D H E Z I M**

**Nr. 3, Date 26.05.2011**

Duke u nisur nga praktikat e deritanishme ku eshte vene re se, autoritetet kontraktore nuk bejne pezullimin e procedurave te prokurimit ne sistem ne rastet kur ka ankesa nga operatore ekonomik, Agjencia e Prokurimit Publik mbeshtetur ne nenin 13/2/d te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, udhezoi te gjitha autoritetet kontraktore qe te respektojne nenin 63 te ligjit te mesiperme, duke pezulluar proceduren e prokurimit ne sistem.

Teknikisht procesi i pezullimit ne sistem kryhet si me poshte:

Për secilin autoritet kontraktor është dërguar llogaria e përdoruesit në rolin e Administratorit të Sistemit të Prokurimit Elektronik, i cili ndër të tjera, shërben për të bërë të mundur edhe pezullimin në sistem të një procedure prokurimi.

Për të kryer pezullimin e një procedure, Administratori i Autoritetit Kontraktor hyn në llogarinë e tij, shkon tek dosja "Shpalljet e pa pezulluara" – (*Not suspended calls*), kërkon tenderin që duhet të pezullojë dhe klikon mbi butonin "Suspend". Në dritaren që vijon do të jepen arsyet e këtij pezullimi dhe do të shtypet butoni "Tjetër". Pasi të jetë kryer ky veprim, procedura e prokurimit do të kalojë në dosjen "Shpalljet e pezulluara".

Për ta nxjerrë këtë procedurë nga pezullimi, administratori duhet të përzgjedhë procedurën përkatëse në dosjen "Shpalljet e pezulluara", dhe të shtypni butonin "Un-Suspend". Në dritaren që vijon duhet të vendosen arsyet e heqjes së këtij pezullimi për këtë procedurë. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për procedurat me lote.

**D R E J T O R**

**Klodiana CANKJA**